

STATISTIKA TË DIPLOMIMEVE

Metadate Referenciale në format Euro SDMX Metadate Structure

(ESMS)

INSTAT

Metadate Referenciale

1. Kontakt.....	2
2. Përditësimi i metadatave	2
3. Paraqitja statistikore.....	2
4. Njësia matëse	5
5. Periudha e referencës	5
6. Mandati institucional.....	5
7. Konfidencialiteti	5
8. Politika e botimit.....	6
9. Shpeshësia e shpërndarjes.....	6
10. Akses në të dhëna dhe qartësia	6
11. Manaxhimi i cilësisë	7
12. Rëndësia.....	8
13. Saktësia dhe besueshmëria.....	9
14. Afatet kohore dhe përpikmëria	9
15. Koherenca dhe Krahasueshmëria.....	9
16. Kostoja dhe ngarkesa	10
17. Rishikimi i të dhënave.....	10
18. Përpunimi statistikor	10
19. Komente.....	11
Aneks	11

1. Kontakt	
1.1. Institucioni i kontaktit	INSTAT, Instituti i Statistikave
1.2. Njësia e kontaktit	Sektori i Zhvillimit të Statistikave Sociale, Drejtoria e Statistikave Sociale
1.3. Personi i kontaktit	Elda Muça
1.4. Funkzioni i personit të kontaktit	Specialist, Sektori i Zhvillimit të Statistikave Sociale
1.5. Adresa postare	Rr. Vllazën Huta, Nd.35, H.1 Njësia Administrative Nr.2, 1017 Tiranë
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	emuca@instat.gov.al
1.7. Numri i telefonit	+(355) 4 2222411 / +(355) 4 2233356
1.8. Numri i faksit	+(355) 4 2228300
2. Përditësimi i metadatave	
2.1. Çertifikimi i fundit i metadatës	13.05.2022
2.2. Publikimi i fundit i metadatës	13.05.2022
2.3. Përditësimi i fundit i metadatës	13.05.2022
3. Paraqitja statistikore	
3.1. Përshkrimi i të dhënave	<p>Diplomimet në arsim</p> <p>INSTAT organizon punën për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave mbi diplomimet e nxënësve dhe studentëve në arsimin zyrtar, bazuar në Programin e Statistikave Zyrtare dhe Ligjin e Statistikës. Mbi bazën e informacionit të mbledhur kryhet llogaritja e treguesve dhe publikimi i statistikave të diplomimeve. Informacioni mblidhet nga çdo njësi që ofron shërbimin arsimor publik ose privat në vend si shkolla, universitete, kolegje etj. Informacioni i mbledhur për arsimin parauniversitar kalon nga njësitë bazë në drejtoritë dhe zyrat arsimore dhe nëpërmjet tyre në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, specifikisht për arsimin profesional. Këto dy Ministri i përcjellin INSTAT-it në formën e tabelave të përmbledhura në Excel të gjithë informacionin e grumbulluar. Informacioni mblidhet dhe përpunohet sipas niveleve arsimore. Të dhënat për diplomimet e arsimit të lartë mblidhen nga Ministria e Arsimit dhe Sportit direkt nga shkollat e larta,</p>

	<p>universitetet ose kolegjet dhe po ashtu në formën e tabelave të përmbledhura në Excel i vihen në dispozicion INSTAT-it. Ato përpunohen më tej deri në llogaritjen e treguesve dhe publikimin e tyre.</p> <p>Stafi mësimdhënës</p> <p>Informacioni mblidhet dhe përpunohet sipas niveleve arsimore dhe llogariten treguesit lidhur me nxënësit ose studentët.</p> <p>Institucionet arsimore</p> <p>Informacioni mblidhet dhe përpunohet sipas niveleve arsimore dhe llogariten treguesit sipas institucioneve arsimore etj.</p>
<p>3.2. Sistemi i klasifikimit</p>	<p>Statistikat e arsimit përpunohen dhe publikohen sipas klasifikimin ISCED-2011.</p> <p>Arsimi në Shqipëri është i organizuar sipas këtyre programeve dhe klasifikuar sipas Klasifikimit ISCED-2011 që përdoret ndërkombëtarisht në statistikën e arsimit :</p> <p>Niveli 0 - Arsimi parashkollor – çerdhe / kopshte</p> <p>Niveli 1 - Arsimi fillor ose cikli i ulët i arsimit bazë</p> <p>Niveli 2 - Arsimi i mesëm i ulët ose cikli i lartë i arsimit bazë</p> <p>Niveli 3 - Arsimi i mesëm i lartë - Gjimnaz / Profesional / Social kulturor</p> <p>Niveli 4 - Arsimi pas të mesmes por jo i lartë</p> <p>Niveli 5 - Arsimi i lartë cikël i shkurtër</p> <p>Niveli 6 - Bachelor ose ekuivalent</p> <p>Niveli 7 - Master ose ekuivalent</p> <p>Niveli 8 - Doktoraturë ose ekuivalent</p> <p>Klasifikimi i Fushave të studimit për arsimin e lartë bëhet në bazë të ISCED-F 2013, ku grupimet kryesore janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1- Shkenca arsimi 2- Arte dhe Shkenca humane 3- Shkenca sociale, Gazetari dhe Informacion 4- Biznes, Administrim dhe Ligj 5- Shkenca natyrore, Matematikë dhe Statistikë 6- Teknologji e Informacionit dhe Komunikimit 7- Inxhinieri, Prodhim dhe Ndërtim

	<p>8- Bujqësi, Pyje, Peshkim dhe Veterinari</p> <p>9- Shëndet dhe mirëqenie</p> <p>10- Shërbime</p>
3.3. Mbulimi i sektorit	<p>Arsimi paraqitet në katër aktivitetet kryesore të tij: regjistrime dhe diplomime të nxënësve dhe studentëve përkatësisht në arsimin parauniversitar dhe atë universitar, institucionet e përfshira në arsim si dhe stafin mësimdhënës.</p>
3.4. Koncepte statistikore dhe përkufizime	<p>Arsimi parauniversitar përfshin arsimin që kryhet nga institucionet arsimore si kopshte, shkolla 9 vjeçare dhe të mesme.</p> <p>Arsimi 9 vjeçar ose arsimi bazë përbëhet nga dy cikle: cikli i ulët ose arsimi fillor i cili kryhet në klasat 1-5 dhe cikli i lartë ose arsimi i mesëm i ulët i cili kryhet në klasat 6-9. Arsimi 9 vjeçar është i detyruar, fillon në moshën 6 vjeç dhe zgjat 9 vjet. Nxënësi është i detyruar të ndjekë arsimin bazë deri në moshën 16 vjeç.</p> <p>Arsimi i mesëm përfshin gjimnazin, arsimin social-kulturor dhe arsimin profesional i cili ndahet në të ulët teknik dhe të lartë.</p> <p>Mësues janë përcaktuar personat, aktiviteti profesional i të cilëve, përfshin transmetimin e njohurive, sjelljeve dhe aftësive që janë përcaktuar në programin arsimor tek nxënësit dhe studentët e regjistruar në institucionet zyrtare arsimore.</p> <p>Institucion arsimor publik klasifikohet si i tillë nëse aktiviteti i tij kontrollohet plotësisht nga autoriteti arsimor publik.</p> <p>Arsimi profesional përfshin programet e arsimit të dizenuara me qëllim përfitimin e njohurive, shkathtësive dhe kompetencave specifike për një profesion të veçantë ose klasë të profesioneve.</p> <p>I diplomuar në një program arsimor, është një nxënës ose student, i cili ka përfunduar në mënyrë të suksesshme të gjitha kërkesat e programit.</p> <p>Raporti bruto i diplomimit është numri i të diplomuarve pavarësisht moshës në një nivel të caktuar, të shprehur si përqindje e popullsisë në moshën e diplomimit teorik, për atë nivel apo program.</p>
3.5. Njësia statistikore	<p>Njësia statistikore janë nxënës, studentë, institucion arsimor si shkollë, institucion i arsimit të lartë, mësues-staf mësimdhënës, etj.</p>
3.6. Popullata statistikore	<p>Nxënës dhe studentë të diplomuar në arsim në përfundim të vitit shkollor sipas gjinisë, programeve dhe niveleve të arsimit, fushave të studimit në institucionet arsimore publike dhe private , mësues dhe pedagogë.</p>
3.7. Zona e referencës	<p>Të dhënat e përmbledhura janë në nivel qarku dhe vendi.</p>

3.8. Mbulimi në kohë	Shumica e të dhënave janë të disponueshme që nga viti 1990.
3.9. Periudha bazë	Nuk aplikohet.
4. Njësia matëse	Të diplomuar në përfundim të vitit shkollor, raporti bruto i diplomimit në një nivel ose program studimi.
5. Periudha e referencës	Ky raport i referohet vitit 2021.
6. Mandati institucional	
6.1. Akte ligjore dhe marrëveshje të tjera	<p>Në nivel kombëtar, Statistikat e arsimit janë bazuar në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ligjin nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”. • Programin Kombëtar të Statistikave Zyrtare për periudhën 2017-2021 • Memorandum me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit .
6.2. Shkëmbimi i të dhënave	<p>INSTAT transmeton rregullisht në UNESCO - UIS të dhëna të detajuara mbi arsimin parauniversitar dhe atë universitar, nëpërmjet plotësimit të pyetësorëve të hartuar paraprakisht nga ky institucion ndërkombëtar. Të dhënat mbulojnë arsimin parauniversitar dhe atë universitar dhe jepen të detajuara sipas çdo programi, publik/privat, gjinisë, moshave etj.</p>
7. Konfidencialiteti	
7.1. Konfidencialiteti - politika	<p>Të dhënat konsiderohen konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore e kërkime shkencore në përputhje me Ligjin Nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”, si dhe Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Mbrojtja e të Dhënave Personale". Neni 31 i ligjit për statistikat zyrtare përcakton qartë që i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është konfidencial dhe mund të përdoret ose botohet vetëm në tabela përmbledhëse të tilla që nuk identifikojnë njësinë burim të informacionit. Identifikim i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht. Kur përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshëm.</p>
7.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave	<p>INSTAT mbron dhe nuk u shpërndan palëve të treta të dhënat e mbledhura nga, apo tek të cilat ka akses, të dhëna këto që mund të shërbejnë në identifikimin drejtpërsëdrejti apo tërthorazi të njësive statistikore që i kanë ofruar të dhënat në fjalë për arsye dhe qëllime statistikore, apo të dhëna të vjela nga burime të tjera administrative. INSTAT ndërmer tërë masat e duhura për të parandaluar dhe bërë të pamundur identifikimin e njësive statistikore përmes mjeteve teknike të tjera që mund të përdoren nga palët e treta. Të dhënat statistikore që mund të bëjnë të mundur identifikimin e njësisë statistikore, shpërndahen nga Instituti i statistikave vetëm në rast se:</p>

	<p>a) këto të dhëna janë trajtuar në mënyrë të atillë, sa nuk krijon paragjykim në lidhje me konfidencialitetin statistikor;</p> <p>b) njësia statistikore ka dhënë miratimin përkatës për bërjen publike të të dhënave.</p> <p>Të dhënat konfidenciale i përcillen INSTAT vetëm për qëllime statistikore dhe vetëm personat që kanë të drejtë aksesit tek to, mund të punojnë me to. Çështjet dhe problemet në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit statistikor verifikohen dhe trajtohen nga stafi i Institutit të Statistikave. Përgjegjësitë e këtij stafi, janë të përcaktojë shkallën e detajeve që mund të shpërdahet dhe të bëhet publike nga Instituti i Statistikave, me qëllim që të bëhet i pamundur identifikimi i njësisë statistikore nga këto të dhëna; kriteret e anonimizimit për të dhënat mikro që u ofrohen përdoruesve; dhënia e aksesit në të dhëna konfidenciale për qëllime shkencore.</p>
8. Politika e botimit	
8.1. Kalendarin e publikimeve	Njoftimet në lidhje me shpërndarjen e statistikave janë botuar në kalendarin e publikimit, i cili është në dispozicion në faqen e internetit. Njoftime dhe vonesat janë para-njoftuar në këtë kalendar. Në rastin e vonesave specifikohet data e publikimit të ardhshëm si dhe shpjegimi lidhur me arsyet e vonesave.
8.2. Aksesin në kalendarin e publikimeve	Kalendari i publikimeve është i aksesueshëm në faqen e internetit të INSTAT.
8.3. Aksesin e përdoruesve	<p>Në përputhje me nenin 34 të Ligji Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare, statistikave zyrtare shpërndahen në mënyrë që të gjithë përdoruesit të kenë të drejtë të menjëhershme dhe të barabartë, përdoren të gjitha format e mundshme të medias, INSTAT-i dhe agjencitë, duke pasur në program përgjegjësitë për shpërndarjen, kërkojnë të përmbushin çdo kërkesë të çdo organizate ose individit, për të dhëna të pabotuara ose analiza të veçanta.</p> <p>Kanalet nga të cilat përdoruesit mund të marrin rezultatet janë si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Website – online release; 2. Kërkesat e shkruara; 3. Publikimi i Diplomimeve; 4. Kërkesa për të dhëna, seksioni për përdoruesit e jashtëm.
9. Shpeshtësia e shpërndarjes	Shpërndarja e të dhënave të arsimit bëhet në baza vjetore.
10. Aksesin në të dhëna dhe qartësia	
10.1. Njoftim për media	<p>Njoftimi për shtyp mbi diplomimet përmban informacion në lidhje me të diplomuarit sipas niveleve arsimore, raportin bruto të diplomimit në arsimin e mesëm, të diplomuarit sipas fushave të studimit në arsimin e lartë, etj.</p> <p>Njoftimi për shtyp për “Statistika të Diplomimeve” publikohet online në faqen e</p>

	internetit të INSTAT.
10.2. Publikime	<p>Përdoruesit mund t'i gjejnë publikimet mbi Statistikat e Arsimit në faqen e internetit të INSTAT të organizuara si më poshtë:</p> <p>Vjetore:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Burrat dhe Gratë në Shqipëri • Shqipëria në shifra • Vjetari statistikor • Vjetari Rajonal Statistikor <p>Botim i dedikuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Statistika të Diplomimeve
10.3. Baza e të dhënave on-line	Të dhënat mbi statistikave të diplomimeve publikohen në faqen zyrtare të INSTAT në seksionin Databaza .
10.4. Aksesimi në të dhënat mikro	Të dhënat e arsimit nuk bëhen të disponueshme në nivel mikro, si pasojë e ruajtjes së konfidencialitetit. Të dhënat e agreguara, janë lloji i vetëm i të dhënave që ofrohet për përdoruesit e jashtëm. Këto të dhëna i jepen përdoruesve në rast se nuk janë konfidenciale bazuar në nenin 31 Ligji Nr. 17/2018 "Për Statistikat Zyrtare".
10.5. Të tjera	Përdoruesit mund të dërgojnë kërkesa të tjera specifike nëpërmjet këtij seksioni të dedikuar për Kontakt .
10.6. Dokumentimi i metodologjisë	<p>Të dhënat janë siguruar nga burime administrative në vend si Ministria e Arsimit dhe Sportit, si edhe ajo e Financave dhe Ekonomisë.</p> <p>Një shpjegim i shkurtër rreth përkufizimeve dhe Metodologjisë për statistikave të arsimit, i vihet në dispozicion përdoruesve në fund të publikimeve si edhe në Press Release-t e Diplomimeve.</p>
10.7. Dokumentimi i cilësisë	Të gjitha punët rreth statistikave të diplomimeve janë të dokumentuara sipas proceseve dhe procedurave të punës.
11. Manaxhimi i cilësisë	
11.1. Sigurimi i cilësisë	<p>INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në ligjin "PËR STATISTIKAT ZYRTARE, Nr. 17/2018, INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice). INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi për</p>

	<p>punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve.</p>
11.2. Vlerësimi i cilësisë	<p>Kontrollet e cilësisë dhe vlerësimi i të dhënave janë veprime që kryen përgjatë tërë procesit. Stafi i përfshirë në faza të ndryshme të përpilimit të të dhënave është i mirë trajnuar dhe me përvojën e duhur.</p> <p>Burimi i të dhënave për Statistikat e Diplomimeve është administrativ. Të dhënat krahasohen me të dhënat e viteve të mëparshme për të dalluar nëse ka koherencë të dhënash apo ka pasur ndryshime të mëdha.</p>
12. Rëndësia	
12.1. Nevojat e përdoruesit	<p>Përdoruesit e statistikave të arsimit klasifikohen si të jashtëm dhe të brendshëm.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përdoruesit e jashtëm janë: <ul style="list-style-type: none"> ○ Institucionet e Administratës Publike; ○ Universitetet; ○ Bizneset, ○ Publiku i përgjithshëm dhe grupet e tjera të interesit; ○ Organizata kombëtare jofitimprurëse; ○ Disa tregues kryesorë dërgohen në Eurostat në pyetësorin Enlargment; ○ Informacion shumë i detajuar dërgohet në UNESCO-UIS, etj. • Përdoruesit e brendshëm janë sektorët brenda INSTAT të cilët përdorin Statistikat e Arsimit si input për punën e tyre. <p>Qëllimi kryesor i prodhimit të Statistikave të Arsimit është sigurimi i një informacioni më të plotë për shkak të rëndësisë sociale që mbartin këto statistika si dhe për nevojat e publikut lidhur me to.</p>
12.2. Kënaqësia e përdoruesit	<p>Page Views (Klikime) në lidhje me Arsimin për vitin 2021 janë rreth 12,675 klikime.</p> <p>Gjatë 2021 INSTAT ka kryer vërtetimin për matjen e kënaqësisë së përdoruesve nga publikimet e INSTAT. Rezultatet e vërtimit tregojnë se cilësia e përgjithshme e Statistikave të Arsimit është vlerësuar me 3.57 (71.4%) nga një shkallë prej 1 (shumë dobët) në 5 (shumë mirë).</p> <p>INSTAT organizon cdo vit Anketën e Kënaqësisë së Përdoruesve.</p>
12.3. Plotshmëria	<p>Plotshmëria e të dhënave për “Statistika të diplomimeve” për vitin 2021 gjykohet duke krahasuar cilësinë dhe sasinë e treguesve të mbuluar në INSTAT nga ato të parashikuara në Programin e Statistikave zyrtare (2017-2021).</p> <p>Shkalla e Plotshmërisë për Statistikat e Diplomimeve, për vitin 2021 rezulton të jetë 100%.</p>

13. Saktësia dhe besueshmëria									
13.1. Saktësia e përgjithshme	Informacioni mbi “Statistika të Diplomimeve” grumbullohet nga burimet administrative dhe të dhënat janë finale.								
13.2. Gabim i kampionimit	Nuk aplikohet pasi është burim administrativ.								
13.3. Gabim jo i kampionimit	Rishikimi i të dhënave ndodh vetëm në rast se institucionet përkatëse rishikojnë të dhënat e dërguara në INSTAT për efekt përditësimi apo ndonjë gabim të mundshëm njerëzor. Nëse institucionet përkatëse rishikojnë të dhënat e dërguara në INSTAT, atëherë në publikimin më të afërt do të pasqyrohen këto ndryshime dhe do të jepet një informacion i shkurtër sqarues për përdoruesit. Gabimet e jo kampionimit trajtohen bazuar në politikën e trajtimit të gabimeve.								
14. Afatet kohore dhe përpikmëria									
14.1. Afatet kohore	<p>Rezultatet mbi “Statistika të Diplomimeve” janë publikuar në faqen e internetit të INSTAT 133 ditë pas përfundimit të periudhës referuese (T + 133 ditë). Periudha referuese e rezultateve të Statistikave të Diplomimeve është 31 Dhjetor 2021.</p> <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>12/31/2021</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>5/13/2022</td> </tr> <tr> <td>Afatet kohore</td> <td>133</td> </tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2021	Data e publikimit	5/13/2022	Afatet kohore	133		
Periudha referuese	12/31/2021								
Data e publikimit	5/13/2022								
Afatet kohore	133								
14.2. Përpikmëria	<p>Të dhënat për “Statistika të Diplomimeve” publikohen bazuar në kalendarin e publikimeve. Publikimi i Statistikave të Diplomimeve në arsim ka qenë i përpiktë në kohë në 100 % të publikimeve të kryera gjatë viteve.</p> <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>12/31/2021</td> </tr> <tr> <td>Data e shpallur</td> <td>5/13/2022</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>5/13/2022</td> </tr> <tr> <td>Vonesa në kohë</td> <td>0</td> </tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2021	Data e shpallur	5/13/2022	Data e publikimit	5/13/2022	Vonesa në kohë	0
Periudha referuese	12/31/2021								
Data e shpallur	5/13/2022								
Data e publikimit	5/13/2022								
Vonesa në kohë	0								
15. Koherenca dhe Krahasueshmëria									
15.1. Krahasueshmëria gjeografike	<p>Statistikat e Arsimit paraqiten në nivel prefekturë dhe vendi. Këto statistika janë relativisht të krahasueshme pasi institucionet që na sigurojnë të dhënat koordinojnë procesin e mbledhjes së të dhënave.</p> <p>Gjithashtu në nivel ndërkombëtar sigurohet krahasueshmëria e tyre e cila bëhet e mundur me dërgimin e të dhënave dhe statistikave të arsimit në institucione ndërkombëtare dhe evropiane. Kushti kryesor që siguron krahasueshmërinë është përdorimi i klasifikimit ndërkombëtar ISCED-2011 në Statistikat e Arsimit në Shqipëri.</p>								
15.2. Krahasueshmëria kohore	Statistikat e Arsimit në lidhje me Diplomimet datojnë që nga viti 1991 referuar databazës statistikore.								

	<p>Nga viti 2004 të dhënat e arsimit parauniversitar sigurohen sipas një formati të caktuar elektronik të përcaktuar nga burimi administrativ dhe INSTAT, duke siguruar një krahasueshmëri në seri kohore prej 18 vitesh (CC2=Jlast-Jfirst+1=18).</p> <p>Ndërsa ato të arsimit universitar, që prej vitit 2008 duke siguruar një krahasueshmëri kohore prej 14 vitesh (CC2=Jlast-Jfirst+1=14).</p>
15.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave	Nuk aplikohet pasi është burim administrativ.
15.4. Koherenca e brendshme	Konsistenca e brendshme e të dhënave kontrollohet para se të finalizohen. Kontrollohen gjithashtu lidhjet midis variablave dhe koherenca në seri të ndryshme.
16. Kostoja dhe ngarkesa	Stafi i përfshirë në përgatitjen e Statistikave të Arsimit pranë sektorit të Zhvillimit të Statistikave Sociale, në drejtorinë e Statistikave Sociale është: 1 punonjës.
17. Rishikimi i të dhënave	
17.1. Politika e rishikimit	<p>Politikat e rishikimit të statistikave të arsimit bëhen në përputhje me politikën e rishikimit si dhe politikën e trajtimit të gabimeve të vendosura nga INSTAT. Për më shumë referohuni:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Politika e Revizionimit • Politika e Trajtimit të Gabimeve
17.2. Praktika e rishikimit	<p>Në rast ndryshimesh në pyetësorët që dërgohen në UNESCO për statistikave të arsimit, INSTAT bën rishikime në të dhënat dhe ridërgon pyetësorët me ndryshimet dhe shpjegimet përkatëse.</p> <p>Nuk janë kryer rishikime të të dhënave mbi “Statistika të Diplomimeve” për vitin 2021, subjekt i këtij raporti.</p>
18. Përpunimi statistikor	
18.1. Burimi i të dhënave	Të dhënat mbi “Statistika të diplomimeve” bazohen në burime administrative. Ofruesit kryesorë të të dhënave të arsimit janë: Ministria e Arsimit dhe Sportit, si edhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë.
18.2. Shpeshësia e grumbullimit të të dhënave	Të dhënat mbi “Statistika të Diplomimeve” mbledhen në bazë vjetore, në përfundim të vitit shkollor ose akademik.
18.3. Grumbullimi i të dhënave	Instituti i Statistikave organizon punën për llogaritjen e treguesve dhe statistikave të arsimit, e orientuar nga Programi i Statistikave Zyrtare dhe Ligji i Statistikës. Ministria e Arsimit dhe Sportit është burimi kryesor i të dhënave për

	të gjitha nivelet e arsimit zyrtar që kryhet në vend sipas këtij programi. Po ashtu Ministria e Financave dhe Ekonomisë është burimi i të dhënave për arsimin profesional. Programi përmban një sistem pasqyrash, që plotësohen me të dhëna sasiore nga të gjitha institucionet arsimore, të mbledhura në mënyrë periodike, në bazë të një metodologjie të caktuar si edhe të përvojës së gjatë kombëtare. Në mbledhjen dhe përpunimin e statistikave të arsimit shqiptar përdoret klasifikimi ndërkombëtar standard i arsimit ISCED, aplikuar fillimisht varianti i vitit 1997, dhe që nga viti 2013 ISCED-2011, sipas rekomandimeve edhe të Eurostat dhe UNESCO-s.
18.4. Vlefshmëria e të dhënave	Kontrollet logjike dhe matematikore aplikohen në të dhënat administrative të arsimit. Ndër metodat e verifikimit të dhënave administrative mund të përmendim: Kontrolli për plotësinë e të dhënave, konsistenca me kalimin e kohës, korigjimet aritmetike (nuk duhet të jenë shumë të larta), kontrollet përmbledhëse, kontrolli i serive kohore nëse ka devijime të mëdha, etj.
18.5. Përpilimi i të dhënave	Nuk aplikohet. Mbulimi është gjithë përfshirës në nivel vendi dhe prefekturë, të dhënat janë administrative dhe informacioni statistikor mundësohet përherë në kohë, prandaj vlerësimi i të dhënave nuk është i nevojshëm.
18.6. Rregullimi	Nuk aplikohet.
19. Komente	
Aneks	